

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIMET MASTER**

**DREJTIMI: FINANCIAR**



**PUNIM DIPLOME**

**PROCESI I PRIVATIZIMIT NË REPUBLIKEN E KOSOVËS – DOBITË  
DHE MANGËSITË E EVIDENTUARA**

**MENTORI:**

**Prof. Dr. Mejdi Bektashi**

**KANDIDATI:**

**Albert Shabani**

**Prishtinë, 2023**

## ABSTRAKT

Procesi i privatizimit, shënon kalimin e pronësisë së fabrikave, bizneseve, tokave dhe formave tjera të pasurisë, nga sektori shtetror, tek ai privat. Sistemi i mëhershëm ekonomik, ai komunist apo socialist, kryefjalë të tij kishte pronësinë shoqërore, ku gjithçka ishte në dorë të shtetit. Mendohej se, ky sistem do të prodhonte barazi absolute në mes të popullisë, andaj filozofia kryesora mbështetej në menaxhimin e pasurive, nga dora e shtetit. Me kalimin e viteve, ky sistem filloi të shfaqte dështimet e tij, duke bërë që përveç tjerash, të rrëshqiste në një performancë jashtëzakonisht joeficiente. Pa hyrë në detaje të shumta, i gjithë sistemi socialist-komunist, konsiderohet si i dështuar. Në këto rrethana, u shfaqe nevoja e ndryshimit të sistemit, e me këtë, lindjes së sistemit të ri, të ekonomisë së lirë të tregut. Një ekonomi, në të cilën, shteti do të kishte vetëm rolin e rregullatorit të lojës ekonomike, por në asnjë mënyrë, të mos ndërhynte në forcat e tregut.

Për të ndodhur privatizimi, natyrisht nuk ishte as e lehtë e as e thjeshtë, e gjithashtu nuk mund të kryhej brenda pak kohe. Andaj, për të kaluar nga sistemi komunist në atë të tregut të lirë, nevojitej një proces i tërë, sa i zgjatur, aq edhe kompleks. Ky proces, njihet me emrin tranzicion, apo fazë kalimtare prej një sistemi në tjetrin. Në punimin tonë, në kemi hulumtuar procesin e privatizimit në vendin tonë. Natyrisht, në fillim të punimit, kemi një përmbledhje dhe përshkrim sistematik, të asaj se, si ka ndodhur privatizimi në disa vendet ish-socialiste, duke elaboruar pikat kyçe që karakterizojnë komplet procesin. Tutje, diskutimin e kemi zhvendosur, në vendet e ish-Jugosllavisë, pjesë e së cilës ishim edhe ne Kosova, e më pas kemi kaluar specifikisht në procesin e privatizimit që ka ndodhur në vendin tonë.

Fillimisht, kemi përshkruar në detaje, natyrën e zhvillimit të komplet procesit, e më pas, kemi evidentuar më saktësi të gjitha veprimet, duke filluar nga themelimi i AKM-së, e për të vazhduar pastaj edhe me AKP-në e cila në fakt është e njejta agjenci. Konkretisht, kemi elaboruar dhe nxjerrë në pah, të gjitha ndodhitë që lidhen me procesin e privatizimit në Kosovën e pas-luftës. Kemi përshkruar gjithashtu, të gjitha valët nëpër të cilat është zhvilluar privatizimi, duke mos harruar evidentimin e metodave të privatizimit të cilat e kanë karakterizuar komplet procesin, si dhe kemi nxjerrë përparsitë dhe mangësitë me të cilat është shoqëruar procesi i tranzicionit, gjegjësisht privatizimit.

**Fjalët kyçe:** *Privatizim, tranzicion, sistem ekonomik, metodat e privatizimit, valët e privatizimit, Agjencia Kosovare e Mirëbësimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit.*

## ABSTRACT

The process of privatization marks the transfer of ownership of factories, businesses, land and other forms of wealth from the state sector to the private sector. The previous economic system, the communist or socialist one, had social ownership as its main word, where everything was in the hands of the state. It was thought that this system would produce absolute equality among the people, therefore the main philosophy was based on the management of assets, by the hand of the state. Over the years, this system began to show its failures, causing, among other things, to slip into unusually inefficient performance. Without going into many details, the entire socialist-communist system is considered a failure. In these circumstances, the need to change the system appeared, and with this, the birth of a new system of free market economy. An economy in which the state would only have the role of regulator of the economic game, but in no way interfere with market forces.

For the privatization to happen, of course, it was neither easy nor simple, and it also could not be done in a short time. Therefore, to move from the communist system to the free market, a whole process was needed, as long as it was complex. This process is known as transition, or transitional phase from one system to another. In our paper, we researched the process of privatization in our country. Of course, at the beginning of the paper, we have a systematic summary and description of how privatization took place in some former socialist countries, elaborating the key points that characterized the entire process. Next, we moved the discussion to the countries of former Yugoslavia, of which Kosovo was also a part, and then we moved specifically to the privatization process that happened in our country.

First, we have described in detail the nature of the development of the entire process, and then, we have more accurately documented all the actions, starting from the establishment of the AKM, and then continuing with the AKP, which in fact is same agency. Specifically, we elaborated and highlighted all the events related to the privatization process in post-war Kosovo. We have also described all the waves through which privatization has developed, not forgetting to highlight the methods of privatization that have characterized the entire process, as well as we have drawn out the advantages and disadvantages with which the process of transition, namely privatization, has been associated.

**Key words:** *Privatization, transition, economic system, privatization methods, waves of privatization, Kosovar Trust Agency, Kosovar Privatization Agency.*